



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:027229
Datë: 24.05.2023
Numri i dokumentit: 04316307

APS.nr.20/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS- DEPARTAMENTI SPECIALE – në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryetar i kolegjit, Vaton Durguti dhe Afërdita Bytyçi-anëtarë, me bashkëpunëtorën profesionale Syzana Goxhuli, në çështjen penale kundër të akuzuarve Xh.Sh për shkak të veprës penale blerja posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së, dhe dhënia e ndihmës kryerësve, pas kryerjes së veprës penale nga neni 380 par.2 pika 2.8 lidhur me par.1 të KPRK-së, S.B, B.R dhe N.M për shkak të veprës penale blerja posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, V.P, për shkak të veprës penale blerja posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe J.A për shkak të veprës penale blerja posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Special të Republikës së Kosovës, ankesës dhe përgjigjen në ankesë të mbrojtëses së të akuzuarit J.A, av.Teuta Zhinipotoku dhe ankesën e të akuzuarit N.M, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore –Departamenti Special në Prishtinë, PS.nr.57/22 të datës 23.01.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), me 16.05.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Special të Republikës së Kosovës dhe e mbrojtëses së të akuzuarit J.A, av.Teuta Zhinipotoku, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special, PS.nr.57/22 i datës 23.01.2023, **VËRTETOHET**.

II.HUDHET si e palejuar ankesa e të akuzuarit N.M e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special PS.nr.57/22 të datës 23.01.2023.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, me aktgjykimin PS.nr.57/22 të datës 23.01.2023, i ka shpallur fajtor të akuzuarit; Xh.Sh për shkak të veprës penale blerja posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së, dhe dhënia e ndihmës kryerësve, pas kryerjes së veprës penale nga neni 380 par.2 pika 2.8 lidhur me par.1 të KPRK-së, S.B, B.R dhe N.M për shkak të veprës penale blerja posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të V.P, për shkak të veprës penale blerja posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe J.A për shkak të veprës penale blerja posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 lidhur me par.1 të KPRK- së, dhe i ka gjykuar si në vijim;

Të akuzuarin Xh.Sh për veprën penale si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 18 muaj dhe dënim me gjobë në lartësi prej 2,000 (dymijë) euro, ndërsa për veprën penale në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh.

Në bazë të nenit 43 par. 5 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit dënimi i shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajsh i zëvendësohet me dënimin me gjobë në lartësi prej 2,000 (dymijë) euro.

Konform nenit 76 gjykata të akuzuarin Xh.Sh e gjykon me dënim unik me gjobë në lartësi prej 4,000 (katërmijë) euro. Koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 11.03.2022 e deri me datën 23.01.2023, i llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Ndërsa të akuzuarve B.R, Suad Bulliq, N.M, Venahar Pajaziti dhe J.A, për veprat penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi i'u shqipton: dënim me burgim dhe dënim me gjobë dhe atë;

-Të akuzuarin B.R për veprën penale si në pikën III të dispozitiv të këtij aktgjykimi e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 18 muaj si dhe dënim me gjobë në lartësi prej 10,000 (dhjetë mijë) euro. Koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 20.04.2022 e deri me datën 23.01.2023, i llogaritet ne dënimin e shqiptuar.

-Të akuzuarin S.B për veprën penale si në pikën III të dispozitiv të këtij aktgjykimi e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 18 muaj si dhe dënim me gjobë në lartësi prej 10,000 (dhjetë mijë) euro. Koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 20.04.2022 e deri me datën 23.01.2023, i llogaritet ne dënimin e shqiptuar.

-Të akuzuarin N.M për veprën penale si në pikën III të dispozitiv të këtij aktgjykimi e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 19 muaj si dhe dënim me gjobë në lartësi prej 10,000 (dhjetë mijë) euro. Koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 20.04.2022 e deri me datën 23.01.2023, i llogaritet ne dënimin e shqiptuar.

Të akuzuarin V.P për veprën penale si në pikën IV të dispozitiv të këtij aktgjykimi e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 18 muaj si dhe dënim me gjobë në lartësi prej 2,000 (dymijë) euro. Koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 16.09.2022 e deri me datën 23.01.2023, i llogaritet ne dënimin e shqiptuar.

Të akuzuarin J.A për veprën penale si në pikën V të dispozitiv të këtij aktgjykimi e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 15 muaj dhe dënim me gjobë në lartësi prej 5,000 (pesëmijë) euro. Koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 16.09.2022 e deri me datën 23.01.2023, i llogaritet ne dënimin e shqiptuar.

Po që se dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, të njëjtin gjykata do ta zëvendësoj me dënim me burgim, duke llogaritur për çdo 20 (njëzet) euro, me 1 (një) ditë burgim.

Konform nenit 59 par. 2 nën par. 2,8 lidhur me nenin 67 të KPRK-së, së bashku me dënimin kryesor të akuzuarve S.B dhe B.R iu ka shqiptuar dënim plotësues; Dëbimi i të huajit nga territori i Republikës së Kosovës në kohëzgjatje prej 5 viteve, dhe kjo kohë llogaritet pasi që të njëjtit ta kenë vuajtur dënimin e shqiptuar.

Të akuzuarit Xh.Sh, konform 282 të KPPRK-së, dhe nenit 267 par.5 të KPRK-së substancat narkotike e llojit marihuanë në peshë prej ... gram, .. qese të najlonit si dhe një peshore elektrike për matjen e narkotikëve si dhe një foli plastike, i është konfiskuar.

Të akuzuarit B.R, konform 282 të KPPRK-së, dhe nenit 267 par.5 të KPRK-së substanca narkotike në peshë totale ... kg, vetura e tipit me targa ..., para në shumë prej 355 euro si dhe dy (2) telefona samsung me kartela i janë konfiskuar.

Të akuzuarit N.M, konform 282 të KPPRK-së, dhe nenit 267 par.5 të KPRK-së substancat narkotike në sasi prej 18 kg 905 gram, vetura e tipit ... me targa, paratë në shumë prej ... euro dhe ... dinar të Serbisë si dhe dy (2) telefona Iphone me dy kartela i janë konfiskuar.

Të akuzuarit Suad Bulliq, konform 282 të KPPRK-së, dhe nenit 267 par.5 të KPRK-së substancat narkotike në sasi prej 10.072 kg, vetura e tipit me targa ..., paratë në shumë prej 352 euro, dhe një (1) telefona Iphone me kartelë vodafon i janë konfiskuar.

Të akuzuarit V.P, konform 282 të KPPRK-së, dhe nenit 267 par.5 të KPRK-së supstancat narkotike në sasi prej 205 gram, një telefon Iphone X max dhe para në shumë 40 euro, i janë konfiskuar.

Të akuzuarit J.A, konform 282 të KPPRK-së, dhe nenit 267 par.5 të KPRK-së substancat narkotike në sasi prej .. gram marihuanë, ..gram kokain, dhegram marihuanë, një peshore elektrike, katër llulla, tre mullinj për bluarje të marihuanës, qese najloni një shufër metalike dhe para të gatshme në vlerë prej ... euro i janë konfiskuar.

Janë obliguar të akuzuarit që secili veç e veç, në emër të shpenzimeve të procedurës penale gjykatës të ia kompensoi shumën prej 200 euro, si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 100 euro, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 100 euro të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar:

Prokurori i Prokurorisë Special të Republikës së Kosovës, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, më propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoi ankesën ndërsa aktgjykim e ankimuar ta ndryshoj apo ta kthej në rivendosje sa i përket vendimit mbi dënim për të akuzuarin J.A.

Mbrojtësja e të akuzuarit J.A, av.Teuta Zhinipotoku, për shkak të vendimit mbi dënim, më propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoi ankesën si të bazuar, ta ndryshoj aktgjykim e ankimuar përkitazi me vendim mbi dënim (lartësinë dhe llojin e dënimit), ashtu që dënimi me burgim dhe dënimin me gjobë ti ndryshoj në atë mënyrë që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim me i butë (lartësia e dënimit me burgim dhe me gjobë) ose lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

I akuzuari N.M, për shkak të vendimit mbi dënim, më propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoi ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj ashtu që ndaj të akuzuarit përkitazi me konfiskimin e mjeteve në shumë prej 9.800, 00 € dhe 6,580.00 € të njëjtat të lirohen nga konfiskimi.

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Speciale e ka ushtruar mbrojtësja e të akuzuarit J.A, av.Teuta Zhinipotoku, me propozim që ankesa e Prokurores Speciale të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa ankesa e ushtruar nga mbrojtësja të aprovohet si e bazuar.

Prokuroria e Apelit me parashtresat, PPA/I.nr.211/2023, të datës 04.05.2023 dhe 13.04.2023 ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Speciale ndërsa aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje ose të ndryshohet sa i përket vendimit mbi dënim në raport me të akuzuarin J.A, kurse ankesa dhe përgjigjja në ankesë të mbrojtëses së të akuzuarit J.A, av.Teuta Zhinipotoku dhe ankesa e të akuzuarit N.M, të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit caktoi dhe mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPP-së, në të cilën prezantuan të akuzuarit J.A dhe Nazmi Aliu si dhe mbrojtëset e tyre av.Teuta Zhinipotoku dhe av.Lindita Keqekolla-Gashi, kurse Prokurori i Apelit edhe pse i njoftuar me rregull nuk mori pjesë në seancë. Mbrojtëset e të akuzuarve pasi që sqaruan disa pretendime ankimore mbështeten propozimet e parashtruar në ankesa, kurse të akuzuarit e mbështeten pretendimet e mbrojtësve të tyre.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, studioi aktgjykimin e kundërshtuar konform dispozitës së nenit 394 të KPP dhe pasi që vlerësoi pretendimet ankimore në ankesa gjeti se: Ankesa e Prokurorisë edhe ajo e mbrojtëses së të akuzuarit J.A, av.Teuta Zhinipotoku janë të pabazuara, ndërsa ankesa e të akuzuarit N.M është e palejuar.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit, të njëjtën e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare edhe në këtë aspekt konform nenit 394 par.1 të KPPK-së, gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të tjera të cilat detyrimisht do të kushtëzonin anulimin e tij.

Po ashtu, me ankesë nuk kontestohet as gjendja faktike të cilën e ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë, prandaj as në këtë drejtim çështja nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, meqenëse konform dispozitës së nenit 383 par.2 të KPP-së, as që mund të kontestohet aktgjykimi i ankimuar përkitazi me këtë bazë ankimore ngase i akuzuari J.A e kanë pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar ndërsa për të akuzuarin N.M kishte aprovuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, andaj aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymë të pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

-Pretendimet ankimore të prokurorisë dhe të mbrojtëses së të akuzuarit J.A, av.Teuta Zhinipotoku dhe Vlerësimi i Gjykatës së Apelit.

Prokurori në ankesë thekson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vepruar kur të akuzuarit i ka shpallur fajtor dhe i ka dënuar, po ashtu drejtë ka vërtetuar edhe gjendjen faktike, mirëpo vendimi mbi dënim për të akuzuarin J.A nuk është në përputhje me gjendjen faktike të konstatuar nga gjykata e shkallës së parë. Sipas prokurorisë sanksioni penal i caktuar nga gjykata është shumë i butë nëse i referohemi minimumit dhe maksimumit të dënimit që është paraparë për këtë veprë penale. Ka shtuar se përveç dënimit me burg edhe dënimi me gjobë është shumë i ulët duke pasur parasysh faktin se i akuzuari këtë veprë penale e ka kryer për qëllime financiarë. Tutje shton se gjykata në rastin e matjes së lartësisë së dënimit nuk mori parasysh shkallën e lartë të pjesëmarrjes së të akuzuarit J.A në kryerjen e kësaj veprë penale, shkallen e dëmit të shkaktuar, rrezikshmërinë shoqërore të kësaj veprë penale, për faktin se i akuzuari ka poseduar dy lloje të narkotikëve dhe gjatë bastisjes në dhomën e gjumit i janë gjetur dhe sekuestruar ... gram substancë të dyshuar marihuan, tre gram kokainë, një peshore elektrike, katër llulla, tre mullinjë për bluarje, ndërsa në shtëpinë ndihmesë (shup) i janë gjetur edhe ... gram substancë e llojit marihuan, andaj me këtë sanksion nuk do të arrihet qëllimi dënimit, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Në ankesë mbrojtësja e të akuzuarit J.A, av.Teuta Zhinipotoku, konsideron se lartësia e dënimit të shqiptuar për të akuzuarin është shume e larte, është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, pasi që nuk janë vlerësuar mirë dhe nuk janë marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese gjatë matjes së dënimit, ashtu që dënimi i marre nuk është brenda kufijve të zbutjes së dënimit, pasi që për veprat penale të cilat i vihen në barre, përmes dispozitave ligjore të cilat i përcaktojnë kufijtë e zbutjes së dënimit, mund t'i shqiptohet dënim me i bute.

Mbrojtja thekson se fillimisht, Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit ka marrë për bazë rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë, gatishmërinë që të hyj në marrëveshje për pranimin e fajësisë, është penduar dhe premtimi se në të ardhmen nuk do të kryej veprë penale, rrethanat personale dhe karakterin e personit të dënuar, të njëjtit shkaktimi i kësaj veprë në mase të madhe e ka lënduar shpirtërisht dhe vet atë, keqardhja e shfaqur nga personi i dënuar, moshën e personit të dënuar, bashkëpunimin e përgjithshëm me gjykatën, sjelljen korrekte në gjykatë dhe me organet tjera të drejtësisë, faktin se gjykata nuk ka të dhëna se i njëjti është i dënuar më parë. Bazuar në këtë shton se sjellja e mëparshme e kryerësit është rrethanë e rëndësishme për çmuarjen e personalitetit të kryerësit dhe rrezikshmërisë shoqërore tij, sjelljet e tija në harmoni me normat pozitive para kryerjes veprës penale, i njëjti ka pasur sjellje korrekte rrethin dhe ambientin ku jeton, nuk është recidivist, çka nënkupton se vepra e kryer nuk është pasojë e sjelljeve jo të rregullta të kryerësit.

Duke pasur parasysh faktin se gjykata e shkallës së parë nuk ka gjetur rrethana renduese dënimi i shqiptuar është shumë i ashpër dhe tutje i është referuar dispozitave nga neni 71 dhe 72 për zbutjen e dënimit konform këtyre dispozitave ligjore, e në pajtim më kufijtë e zbutjes së dënimit, në rastin konkret të akuzuarit J.A, gjykata e shkallës së parë është dashur që sa i përket veprës sipas pikës V të dispozitivit të zbus dënim me burgim si dhe dënim me gjobë, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet ankimore të Prokurorisë për një dënim më të ashpër për të akuzuarin J.A dhe të mbrojtëses së të akuzuarit J.A, av.Teuta Zhinipotoku për një dënim me të butë nuk janë të bazuara.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka marrë parasysh dhe ka vlerësuar drejt të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Kështu, duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për zbutjen e dënimit Gjykata e shkallës së parë, për të akuzuarin J.A ka vlerësuar pranimin e fajësisë, pasi që i akuzuari që në

shqyrtimin fillestar ka pranuar fajësinë, dhe po ashtu ka shprehur gatishmëri që të hyj në marrëveshje për pranimin e fajësisë, ka pranuar se ka kryer veprën penale, është penduar, dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej veprë penale, pastaj rrethanat personale dhe karakterin e personit të dënuar, të njëjtit shkaktimi i kësaj vepre në masë të madhe e ka lënduar shpirtërisht edhe vet atë, keqardhja e shfaqur nga personi i dënuar, moshën e personit të dënuar i njëjti është i moshës së re, bashkëpunimin e përgjithshëm me gjykatën pasi që i njëjti ka pasur sjellje korrekte në gjykatë dhe me organet të tjera të drejtësisë si dhe faktin se për të njëjtin nuk ka të dhëna se ka qenë i dënuar më parë. Gjithashtu duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për ashpërsimin e dënimit, ka gjetur; shkallën e lartë të pjesëmarrjes; pasi që i akuzuari me vetëdije të plotë ka dashtë që të kryhet kjo veprë penale; shkallën e dëmit të shkaktuar, faktin se këto vepra penale janë shumë të shprehura në Kosovë, faktin se këto vepra penale kanë ndikim negativ tek qytetarët, ndërsa rrethanë veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti.

Kurse në rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, për të akuzuarit e tjerë të cilët kanë arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë e të rekomanduar në Marrëveshjen e pranuar nga gjykata, gjykata e shkallës së parë gjithashtu ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 69 të KPRK-së, ku si rrethana lehtësuese ka vlerësuar sjelljen e tyre korrekte në gjykatë gjatë shqyrtimit, pranimin e fajësisë, pendimin e thellë për veprën e kryera penale, sinqeritetin e tyre deklarues, e të gjitha këto të përfshira në marrëveshjen për pranimin e fajësisë, në të cilën janë dakorduar për vendimin mbi dënimin dhe lartësinë e tij. Duke i vlerësuar rrethanat e lartcekura dhe duke pasur parasysh faktin se gjykata ka pranuar Marrëveshjen për pranimin e fajësisë të akuzuarve iu ka shqiptuar dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa rrethanat e pretenduara rënduese në ankesën e prokurorit se dënim është tejet i ulët në raport me shkallën e dëmit të shkaktuar, rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale, janë pretendime të pabazuara, dhe si të tilla ishin vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, ndërsa në anën tjetër nuk potencon ndonjë rrethanë të re të cilën gjykata nuk e ka vlerësuar gjatë matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit andaj vetëm theksimi i këtyre rrethanave në mënyrë të përgjithësuar nuk janë të asaj natyre që të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, ndërsa disa nga rrethanat në të cilat mbrojtësja të akuzuarit i potencon janë rrethana të cilat veç se kanë qenë objekt vlerësimi nga ana e gjykatës së shkallës duke qenë se

gjykata e ka vlerësuar edhe rrethanat të cekuar si në pretendimet ankimore se për të njëjtin nuk ka të dhëna se ka qenë i dënuar më parë, andaj të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e Gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve si dhe me intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se me të do të mund të parandalohen të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Ndërsa përkitazi me ankesën e ushtruar nga i akuzuarit N.A, Kolegji i kësaj Gjykate e gjënë si të palejuara dhe si e tillë është hudhur, pasi që në bazë të vetë ankesës por edhe shkresave tjera në lëndë, rezulton se në këtë çështje penalo-juridike, pas ngritjes së aktakuzës palët kanë negociuar marrëveshje për pranimin e fajësisë në të cilin marrëveshje për të akuzuarin N. A, është përfshirë rekomandimi dhe i konfiskimit të veturës se tipit me targa, paratë në shumë prejeuro dhe dinar të Serbisë si dhe dy (2) telefona Iphone me dy kartela.

Prandaj, pasi që palët kanë arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë, të njëjtën marrëveshje në formë të shkruar ia kanë propozuar gjykatës së shkallës së parë, e cila pasi ka vepruar konform dispozitave të nenit 233 par. 18 të KPPK-së, në shqyrtimin fillestare të datës 23.01.2023, ku ka përcaktuar se në rastin konkret të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht dhe atë pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre e po ashtu pa kurrfarë detyrimi apo presioni tjetër, se pranimi i fajësisë po ashtu ka mbështetje në fakte dhe prova materiale dhe dëshmi tjera – si deklaratat e dëshmitarëve por edhe vetë të akuzuarve, si dhe provat materiale dhe se nuk ka rrethana të cilat pengojnë ndjekjen penale të parapara nga neni 253 par. 1 dhe 2 të KPPK-së, pra, si shkaqe për hudhje të aktakuzës, e njëjta – pra, gjykata e shkallës së parë pasi është bindur se janë plotësuar të gjitha kushtet e cekura si më lartë, me aktvendim ka aprovuar marrëveshjen me shkrim për pranim fajësisë të paraqitur nga Prokuroria, e cila pra marrëveshje ishte arritur ndërmjet Prokurorisë në njërën anë dhe të akuzuarit dhe mbrojtëses së tij në anën tjetër, me shenjë PPS.nr.32/22 e datës 08.11.2022, e cila më pas ishte vendosur në shkresat e lëndës.

Në marrëveshje të parashtruar me shkrim para gjykatës, ndër të tjerat palët kanë paraparë, po ashtu edhe dispozitën e cila ka paraparë kufijtë e shqiptimit të dënimit për veprën penale për të cilën të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë – kuptohet në bazë të marrëveshjes për pranim fajësie, ku palët janë pajtuar edhe për kufijtë e dënimit ashtu që janë pajtuar që të rekomandojnë në pikën “I. Për veprën penale blerja posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dënimin me burgim 19 muaj dhe dënimin me gjobë në vlerë euro, ndërsa në pikën II. Bazuar në dispozitën e nenit 267 par.5 i pandehuri pajtohet që t’i konfiskohen vetura e tipit me targa ..., parat në shumë euro dhe ... dinar të sërbisë, dy telefona Iphone me dy kartela”, pra edhe çështjen e konfiskimit e të cilën në këtë rast gjykata e shkallës së duke marrë për bazë këtë marrëveshje ka shqiptuar dënimin e rekomanduar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Andaj, duke pasur parasysh të cekurat si më lartë, pra, se palët në marrëveshjen me shkrim për pranim fajësie përveç dispozitave të tjera kanë paraparë edhe heqjen dorë nga e drejta për ankesë atëherë rezulton qartë se konform dispozitës të nenit 233 par.13 të KPPRK-së, sipas të cilës decidivisht parashihet se nëse gjykata nuk shqipton dënim brenda kufijve të marrëveshjes, atëherë pala ka të drejtë në ankesë kundër vendimit mbi dënimin e që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënimin në suazat e propozuara në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, e pranuar nga i akuzuari dhe mbrojtësja e tij, nënkupton se ligjërish i akuzuari nuk ka të drejtë të ushtrojë ankesë ndaj aktgjykimin, meqenëse sipas marrëveshjes për pranimin e fajësisë i akuzuari ka heq dorë nga e drejta për të parashtruar ankesë, prandaj mbi këtë bazë ligjore dhe është hudhur si e pa lejuar ankesa e të akuzuarit e paraqitur ndaj aktgjykimit të ankimuar.

Nga arsyet e sipër cekura, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

DEPARTAMENTI SPECIAL

APS.nr.20/2023, datë 16.05.2023

Bashkëpunëtorja Profesionale,

Anëtarët e kolegjit,

Kryetar i kolegjit,

Syzana Goxhuli

Vaton Durguti

Ferit Osmani

Afërdita Bytyçi